



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.235/24

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkallës së Dytë, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Krenar Berisha, kryetar i kolegjit, Dren Rogova dhe Ramush Bardiqi, anëtar të kolegjit, në konfliktin administrativ sipas padisë së paditësit BprAL Kolegji “ISPE” me seli në Prishtinë, kundër të paditurës Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshillit Shtetëror të Cilësisë me seli në Prishtinë, me bazë juridike, anulim vendimi, duke vendosur lidhur me ankesën e përfaqësuesit të autorizuar të paditësit, të ushtruar kundër Aktgjykimit të Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për çështje administrative, K.A.nr.296/22 të datës 27.11.2023, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 21.03.2024, merr këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar ankesa e paditësit BprAL Kolegji “ISPE” me seli në Prishtinë, ndërsa Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.296/22 i datës 27.11.2023, VËRTETOHET

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.296/22 i datës 27.11.2023, është Refuzuar si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësit BprAL Kolegji “ISPE” me seli në Prishtinë, kundër të paditures Agjencia e Kosovës për Akreditim, Këshilli Shtetëror të Cilësisë me seli në Prishtinë, për anulimin e vendimit A.nr.03/2019 datës 28.03.2019 me propozim që Gjykata ta aprovoj padinë si të bazuar dhe të anuloj vendimin si të pabazë dhe të detyrohet që paditësit t,ia kompensoj dëmin material në emër të fitimit të humbur dhe jo material, për shkak të degradimit të reputacionit dhe emrit jo të mirë.

Kundër këtij aktgjykimi në afat ligjor ka parashtruar ankesë paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar Shoqëria e avokatëve Sejdiu&Qerkini në Prishtinë, për shkak të: shkeljes së dispozitave procedural, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjenjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që ankesa e paditësit të aprovohet si e bazuar, të prishet aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.296/22 i datës 27.11.2023 si i kundërligjshëm dhe çështja të kthehet në rivendosje ose të Ndryshohet aktgjykimi i atakuar, ashtu që të aprovohet në tërsi kërkespadija e paditësit si e bazuar.

Në përgjigjen në ankesë e paditura i propozon Dhomave të shkallës së dytë, që ta refuzoj si të pabazuar ankesën e përfaqësuesit të paditësit dhe të vërtetohet aktgjykimi Aktgjykimi i Gjykatës Komerciale të Kosovës, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Administrative, K.A.nr.296/22 i datës 27.11.2023.

Gjykata Komerciale e Kosovës - Dhomat e Shkallës së Dytë, shqyrtoi shkresat e lëndës, aktgjykimin e ankimuar, pretendimet ankimore, dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, dhe nenit 49 të Ligjit për Konfliktet Administrative, gjeti se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se në procedurën administrative të ankesave, e paditura Komisioni i Ankesave i Agjencisë së Kosovës për Akreditim me seli në Prishtinë, me vendimin numer A.nr.03/2019 i datës 28.03.2019, ka Refuzuar si të pabazuar ankesën e datës 04.03.2019 të paditësit BprAL Kolegji “ISPE” me seli në Prishtinë, dhe ka Lënë në fuqi vendimin nr.ref.151/19D datës 05.02.2019 i Këshillit Shtetëror të Cilësisë të Agjencisë së Kosovës për Akreditim.

Paditësi i pakënaqur me vendimin e lartcekur të paditurës, ka ushtruar padi në konflikt administrativ me datën 06.05.2019, me pretendim se vendimi i të paditurës është i pa drejtë dhe i paligjshëm. Gjykata e shkallës së parë pas shqyrtimit të padisë së paditësit BprAL Kolegji “ISPE” me seli në Prishtinë, paraqitur kundër vendimit të paditës, dhe pas administrimit të provave si në procesverbal të shqyrtimit kryesor datës 20.11.2023, e duke u bazuar edhe në provat

dhe dëshmitë e tjera të lëndës, bie aktgjykimin e ankimuar me të cilin kërkesëpadinë e paditësit e refuzon si të pa bazuar.

Në arsyetim të aktvendimit, Dhoma e shkallës së parë referohet ne Ligjin 04/L-037 për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës, neni,7, 26 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim, LPPA-së. Gjykata konstatoi se dokumentacioni i dorëzuar me programe specifike të akreditimit nuk është bërë konform kërkesave ligjore sikurse parashihet me Udhëzim Administrativ dhe me legjislacionin përkatës i cili rregullon akreditimin e programeve të studimit të bartësve të arsimit të lartë në Republikën e Kosovës. Gjykata vleron se paditësi në kundërshtim me kërkesat ligjore, për fushat e lëndëve për të cilat është refuzuar akreditimi ka propozuar staf akademik të cilët nuk i përkasin fushës së lëndës së caktuar. Vendimi i kundërshtuar është i bazuar në mungesë të stafit akademik të fushave përkatëse të programeve të studimeve dhe realizimit të mardhënies se rregullt të punës në më shumë se një institucion të arsimit të lartë, është marrë konform nenit 26 pika 5,3,4 dhe nenit 30 të Udhëzimit Administrativ për Akreditim. Prandaj gjykata vleron se nga provat e administruara nuk u vërtetua një gjendje tjetër faktike nga ajo e vërtetuar nga e paditura dhe se vendimi i kundërshtuar nr.ref.151/19D datë 05.02.2019 është nxjerr plotësisht në pajtim me nenin 48 dhe 52 të LPPA-së.

Qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë, si të rregullt dhe të bazuar në ligj në tërësi e pranon edhe kjo gjykatë, për arsye se aktgjykimi i ankimuar nuk është përfshirë me shkelje qenësore të dispozitave të Ligjit për Konfliktet Administrative dhe dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore, të cilat shkelje gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, Gjykata e shkallës së parë duke vlerësuar ligjshmërinë e vendimit të kontestuar në kuptim të nenit 9 dhe 44 par.1 të Ligjit për Konfliktet Administrative, në drejtim të thënieve në padi, në përgjigje në padi, provave të administruara në seancë gjyqësore si dhe pas shqyrtimit të shkresave të tjera të lëndës me të drejtë i'u ka referuar dispozitave ligjore të nenit 26 të Ligjit Nr.04/L-037 për Arsimin e Lartë,, që parasheh:

*1. Titujt dhe gradat e personelit, kriteret e emërimeve dhe riemërimeve dhe çështje të tjera të lidhura me këto, specifikohen në statutin e çdo bartësi të arsimit të lartë. Ato duhet të jenë të hapura ndaj shqyrtimit nga AKA-ja dhe të jenë në pajtim me legjislacionin në fuqi për marrëdhënien e punës në Republikën e Kosovës. 2. Universitetet dhe kolegjet universitare për stafin akademik mund të caktojnë titujt si në vijim: 2.1. profesor i rregullt; 2.2. profesor*

*i asociuar; 2.3. profesor asistent; 2.4. asistent universiteti. 3. Kriteret për secilin titull do të përfshijnë të paktën një diplomë Master në fushën e lëndës së të emëruarit. Përveç kësaj, profesorët e rregullt, profesorët e asociuar dhe profesorët asistentë duhet të jenë në gjendje të dëshmojnë një sfond të suksesshëm të mësimdhënies, hulumtimit dhe të praktikës profesionale apo artistike, që do të vlerësohet nga së paku tre recensues që kanë së paku një titull më të lartë se thirrja aktuale e kandidatit për avancim.*

Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, vlersoi se në rastin konkret gjykata e shkallës së parë me të drejt ka refuzuar kërkesëpadin e paditësit për anulimin e vendimit të paditues 03/2019 datës 28.03.2019, për shkak se paditësi me rastin e parashtrimit të kërkesës për riakreditim të programeve të studimit: Studime Evropiane, MA,120 ECTS (me specializime, Integrim e Ekonomike Evropiane dhe Politikat e BE), Studime të integruara Evropiane, BA,180 ECTS, Studime të Sigurisë, BA, 180 ECTS, Gazetari, BA,180 ECTS, dhe infermieri, BSc, 180 ECTS, nuk i ka plotsuar kriteret ligjore, me paraqitjen e aplikacionit për sfafin e deklaruar.

Nga dosja e verifikuar për secilin staf akademik e paditura ka gjetur se paditësi nuk ka vepruar sipas kërkesave ligjore, pasi që nga verifikimi i dokumentacionit të stafit akademik të prazantuar nga paditësit-Kolegji ISPE, nuk janë plotsuar kriteret ligjore: në mungesë të stafit të fushës së programeve të studimit dhe për realizim të mardhënies së rregullt të punës në më shumë se një institucion të arsimit të lartë bazuar në nenin 26 pika 5.3.4, 5.3.11 dhe 5.3.14 të Udhëzimit Administrativ 15/2018, për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës.

Sa i përket pretendimeve ankimore se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të gabuar ka kosntatuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar gabimisht dispozitat materiale, Kolegji i Dhomës së shkallës së dytë, nuk i aprovoi këto pretendime si të bazuara ndërsa aktgjykimi i ankimuar i gjykatës së shkallës së parë është i qartë dhe i kuptueshëm, ndërsa në arsyetimin e tij i janë dhënë arsyet të mjaftueshme për faktet vendimtare të cilat i pranon edhe kjo gjykatë. Meqë në kohën kur paditësi ka aplikuar për riakreditimin e programeve të studimit ka hyr në fuqi Udhëzimi administrative nr.15/2018 për Akreditimin e Instiucioneve të Arsimit të lartë, Kolegji vlersoi se nuk mund të merren për bazë pretendimet ankimore se programet në të clat është refuzuar riakreditimi nga e paditura, kanë qenë të akredituara për dhjete vjet. Paditësi në ankes nuk ka qenë në gjendje të paraqes argumente të kundërta të cilat i ka vërtetuar gjykata e shkallës së parë dhe e paditura, të cilat kanë dhënë spjegime konkrete për secilin program të studimit që nuk janë

riakredituar, sepse referuar dispozitave ligjore, paditësi ka deklaruar staf që nuk i plosojn kriteret ligjore, ka mungesë të stafit akademik në fushat përkatëse të programeve të studimeve.

Kolegji gjithashtu vlersoi se në këtë rast nuk gjejnë mbështetje ligjore pretendimet ankimore të paditësit, se e paditura ka shkelur nenin 18 të Udhëzimit Administrativ nr.15/2018 për Akreditimin e Instiucioneve të Arsimit të lartë. Meqë në rastin konkret kemi të bëjmë me kërkesën e paditësit për riakreditim, e cila procedurë përfshin hapat konkret sipas nenit 10 pika të Udhëzimit administrativ nr.15/2018, ku përfshihen edhe autorizimet e paditurit KSHC (par. 1 pika 1.3) të marr vendim që ta refuzoj aplikacionin për riakreditim, kur nuk janë plotësuar kushtet formale sipas akteve juridike në fuqi, dhe në anën tjetër paditësi nuk argumenton para të paditures se stafi i deklaruar akademik plotëson kriteret ligjore në fushat përkatëse, Kolegji nuk i aprovoi pretendimet ankimore se e paditura në këtë fazë të procedurës ka anashkaluar vlersimin e jashtëm nga ekspertët akademik.

Duke marrë parasysh se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë ka zbatuar dispozitat procedurale dhe materiale me rastin e refuzimit të kërkesëpadisë të paditësit dhe lënies në fuqi të vendimit të paditures, e pasi që me pretendimet tjera ankimore, një aktgjykim i tillë nuk mund të vihet në pyetje, ankesa e paditësit u refuzua si e pa bazuar, ndërsa aktgjykimi i ankimuar u vërtetua si i drejtë dhe i ligjshëm.

Mbi këtë bazë e në mbështetje të nenit 12 të Ligjit 08/L-015, lidhur me nenin 49 të LKA-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II.nr.235/24 datë 21.03.2024

Kryetar i kolegjit,

Krenar Berisha